

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.61/2012, “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Përgatitja e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është pjesë e programit politik.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nga data 1 janar 2014, pijet energjike u trajtuan si produkte me akcizë, në masën 50 lek/litri. Për shkak të vështirësive në zbatim nga administrata doganore propozohet të hiqen pijet energjike si produkte me akcizë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe nenit 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTIT NORMATIVE)

Ky projektligj nuk propozohet në kuadër të përafrimit me legjislacionin evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përmban gjashtë nene, në të cilat propozohet heqja nga përmbajtja e ligjit dhe nga Shtojca e Mallrave të Akcizueshme të produktit “pije energjike” si produkt me akcizë.

Pijet energjike u trajtuan si produkt me akcizë nga data 1 janar 2014.

Akcizimi i pijeve energjike bëhet në bazë të shkronjës “ç”, të nenit 2, të ligjit për akcizat, në të cilin përcaktohet se:

“2. “Akcizë” është një taksë që zbatohet mbi produktet e akcizës, të prodhuara dhe të importuara, që hidhen për konsum në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. “Produkte që i nënshtrohen akcizës” janë:

- a) produktet energjetike;
- b) alkooli dhe pijet alkoolike;
- c) duhani e produktet e duhanit;
- ç) produktet e tjera, të përcaktuara nga ky ligj.

Në bazë të të dhënave të administratës doganore, për 9 - mujorin 2014 janë importuar 3339 ton pije energjike dhe janë prodhuar brenda vendit 992 ton. Aktualisht nga kjo akcizë janë vjelur rreth 216 milionë lekë dhe vlerësohet që për gjithë vitin 2014 do të mblidhen rreth 282 milionë lekë.

Muajt	Pije Energjike Import		Pije Energjike Deklaruar me DSHA	
	Ton	Akcize e paguar në mijë lekë	mije litra	Akcize e paguar në mijë lekë
Janar	154	7,619	0	0
Shkurt	198	9,703	0	0
Mars	261	12,557	48	2,400
Prill	362	17,730	0	0
Maj	199	9,740	630	31,497
Qershor	622	29,943	172	8,591
Korrik	403	18,969	94	4,708
Gusht	453	22,252	29	1,448

Shtator	687	33,802	19	936
Tetor				
Nëntor				
Dhjetor				
Progresiv 2014	3,339	162,315	992	49,580

Burimi : Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Propozimi për heqjen e akcizës së pijeve energjike është se kjo akcizë ka pasur një efekt negativ tek operatorët ekonomikë dhe në deklasifikimin e produkteve energjike.

Në bazë të nenit 76, të ligjit për akcizat, pijet energjike janë pije që klasifikohen në Kodin e Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave 2202 10 00 dhe që kanë në përmbajtje të tyre sasi kafeine të barabartë ose më shumë se 0,03 % të volumit ose përbërësit taurinë, guaranë ose ginsenk.

Në përcaktimin e pijeve energjike ka shumë elemente teknike, për të cilat administrata doganore ka pasur vështirësi në klasifikimin e tyre. Më konkretisht, linjat e prodhimit të cilat shërbejnë për prodhimin e produktit “pije energjike”, shërbejnë njëkohësisht edhe për prodhimin e pijeve freskuese, çka sjell vështirësi në verifikime dhe mbajtje nën kontroll të prodhimit. Elementet përbërëse të produktit “pije energjike”, përqindja e të cilëve përcakton nëse produkti është apo jo pije energjike, aktualisht nuk mund të analizohen në laboratorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave apo në ndonjë laborator tjetër në Shqipëri.

Përpos kësaj, operatorët ekonomikë kanë ndryshuar klasifikimin e pijeve energjike për të mos u konsideruar si produkte me akcizë, sidomos në import. Kjo ka rezultuar në dëmtim të prodhimit vendas, kostoja e të cilit është më e lartë se prodhimi i importit.

Aplikimi i taksës së akcizës prej 50 lekë/litër për pijet energjike ka sjellë rritje direkte të kostos prej 12.5 lekë/kanaçe 250 ml. Një kanaçe pije energjike prodhim vendas shitet me 80 lekë/copë, dhe një rritje në kosto prej 12.5 lekë/copë, ka ndikuar ndjeshëm në rënien e shitjeve deri në ndërprerje të prodhimit. Ndërsa një kanaçe pije energjike importi shitet mesatarisht 150 lekë/kanaçe 250 ml, dhe një rritje prej 12.5 lekë/copë nuk ka patur ndikim në rënie të shitjeve të këtij produkti nga importi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Ministria e Financave ka draftuar projektligjin.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj ka një efekt negativ në të ardhurat nga akciza në vlerën 282 milionë lekë, për vitin 2015.

KËSHILLI I MINISTRAVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____ / 2014

PËR

**DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.61/2012, “PËR AKCIZAT
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Titulli i kreut IX ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KREU IX
KAFEJA”.

Neni 2

Shkronja “c”, e nenit 76, “Përkufizime”, shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalia e fundit shfuqizohet.
2. Në pikën 3, fjalët “...pijeve energjike...” shfuqizohen.

Neni 4

Në titull dhe në përmbajtje të nenit 89/2, fjalët “...pjet energjike...” shfuqizohen.

Neni 5

Në shtojcën 1, që i bashkëlidhet ligjit, hiqet produkti “Pije energjike”, i klasifikuar në kategorinë D000, me Kod të NKM-së 22 02 10 00.

Neni 6

Ky ligj botohet në “Fletoren zyrtare” dhe hyn në fuqi më 1 janar 2015.

K R Y E T A R I

ILIR META